

43 Filipianëve – Përqafimi i qëllimeve të Perëndisë

Në mesazhin tonë të kaluar, ju kam treguar sesi Pali kishte një përqsasje të ekuilibruar ndaj jetës së Krishterë. Nga njëra anë e dinte që nuk e kishte arritur synimin, që kishte edhe shumë udhë për të bërë para se të arrinte përsosjen gjë të cilën nuk do ta arrinte para ringjalljes prej së vdekuri. Nga ana tjetër nuk i lejoi dobësitë dhe mangësitë e tij ta dekurajonin. Ai vazhdoi të shkonte përpara drejt synimeve për të cilat Krishti e kishte shpëtuar, apo nëse përdorim fjalët e Filipianëve 3:12, ai vazhdoi të rendte përpara të zinte atë për të cilën Krishti e kishte zënë vetë Palin.

Le të shohim sërish Filipianëve 3:12.

Jo se unë tashmë e fitova çmimin ose jam bërë i përsosur, por po vazhdoj të rend për ta zënë, sepse edhe unë u zura nga Jezu Krishti.

Herën e kaluar ju tregova sesi Krishti na ka zënë të gjithëve ne për katër arsye.

1. Për të formuar karakterin e tij në ne në mënyrë që të jemi sërish sipas shembëlltyrës së Perëndisë.
2. Të ketë një marrëdhënie me ne që një ditë ka për të arritur kulmin e saj në një përjetim ballë për ballë me Perëndinë e gjallë.
3. Të na pajisë për shërbesë për këtë epokë e cila në fakt është trainim për shërbesë në epokën që po vjen kur të mbretërojmë me të.
4. Që t'ia kushtojmë trupin tonë atij si përgatitje për trupin tonë të ringjallur kur të mbretërojmë me të.

Tani që e dimë pse Krishti na shpëtoi, tani që e dimë pse na ka zënë duhet të rendim përpara për t'i kapur këto synime.

Le të mësojmë si ta bëjmë këtë gjë. Krishti ju ka zënë në mënyrë që të ndërtojë karakterin e tij në ju. 2 Korintasve 3:18 thotë, “Dhe ne të gjithë, duke soditur fytyrëzbuluar lavdinë e Zotit si në pasqyrë, transformohemi në të njëjtën shembëllim nga lavdia në lavdi, posi prej Frymës së Zotit.” Synimi i Perëndisë është të na transformojë. Synimi i tij është të na bëjë si pamja që shohim. Çfarë shohim ne? Sipas këtij vargu ne shohim lavdinë e Zotit dhe kjo lavdi përfaqëson shenjtërinë, dashurinë dhe mirësinë e tij. Ai dëshiron që ne të jemi të shenjtë. Ai dëshiron që të jemi burra dhe gra të dashur. Ai dëshiron që ne të jemi burra dhe gra plor mirësi. Kjo është arsyeja pse na krijoi simbas shembëlltyrës së tij, mëkati e ka shtrembëruar këtë shembëlltyrë, por Fryma e Perëndisë ka ardhur në jetën tonë, Fryma e Perëndisë na ka zënë, për të na rikrijuar, për t'i mbledhur copëzat e thyera të jetës tonë.

Prandaj si mund ta kapim këtë synim? Së pari, duhet të kuptojmë përparësinë e karakterit. Disa të krishterë bien në grackën e të bërit shumë gjëra. Po flisja me një djalosh të ri që një herë kishte një shërbesë të rinjsh që po rritej dhe një pozitë me përgjegjësi të madhe. Gjërat po shkonin mirë, derisa qëlloi dikë me grusht. Ai e pranoi që kjo gjë kishte ndodhur shumë vite më parë, dhe shërbesa kishte vazhduar përtej dobësisë së karakterit të tij. Tani ai është fokusuar në rindërtimin e një marrëdhënieje me Krishtin, ta lejojë Krishtin të punojë brenda tij dhe jo thjesht përreth tij.

Kjo kërkon që të mësojmë të ngadalësohemi dhe të kalojmë kohë me të. Kërkohet që të lexojmë fjalën e tij dhe ta lejojmë Frymën e Tij t'i flasë frymës tonë për ato zona të jetës që kanë nevojë të ndryshojnë. Kërkohet që ne të lutemi me zjarr që ato ndryshime të ndodhin në jetën tonë. Kërkohet që ta lejojmë atë të na udhëheqë në dhe përmes situatave të vështira që do t'i japin formë karakterit tonë. Kjo është arsyeja pse Jakobi 1:2-4 thotë, "Ta konsideroni një gëzim të madh, o vëllezër të mi, kur ndodhëni përballë sprovash nga më të ndryshmet, duke e ditur se sprova e besimit tuaj sjell qëndrueshmëri. Dhe qëndrueshmëria të kryejë në ju një vepër të përsosur, që ju të jeni të përsosur dhe të plotë, pa asnjë të metë." **Përqafoni rritjen në karakter për të cilën Krishti ju shpëtoi.**

Ja arsyeja e dytë pse Ai ju shpëtoi, për të pasur një marrëdhënie me të. Kjo duket në vargjet e para të Zbulesës 22 ku thuhet:

Dhe më tregoi lumin e pastër të ujit të jetës, te kthjellët si kristali, që dilte nga froni i Perëndisë dhe i Qengjit. Në mes të sheshit të qytetit, këtej e andej lumit, ishte druri i jetës që jep dymbëdhjetë fruta, dhe që nxjerr frutin e saj në çdo muaj; dhe gjetet e drurit janë për shërim të kombeve. Dhe asnjë mallkim nuk do të ketë më; dhe në të do të jetë froni i Perëndisë dhe i Qengjit, dhe shërbëtorët e tij do t'i shërbejnë; ata do të shohin fytyrën e tij, dhe emri i tij do të jetë mbi ballin e tyre."

"Ata do të shohin fytyrën e tij," thotë Gjoni. Imagjinoni të përpiqeni të keni një marrëdhënie në këtë jetë me dikë fytyrën e të cilin nuk e shihni kurrë. Sa herë shkoni tek ai person e ka fytyrën e mbuluar. Nuk mund t'ia shohësh dot sytë. Nuk mund t'ia shohësh dot buzëqeshjen. Nuk mund të shohësh dot as lotët apo ndonjë shprehje tjetër. Mimika e fytyrës tonë komunikon shumë dhe kur jemi ballë për ballë me njëri-tjetrin mësojmë shumë për personin tjetër dhe kështu mund të komunikojmë shumë qartë. Në kohën tonë me komunikim elektronik përmes imejlit një pjesë e këtyre gjërave kanë humbur. Shpesh tristohemi që na ka shpëtuar qëllimi i vërtetë i një mesazhi për shkak se nuk e shohim gjuhën trupore, nuk dëgjojmë tingullin e zërit dhe nuk shohim shprehjen e fytyrës. Kjo është arsyeja pse takimet ballë për ballë janë aq më të mira.

Oh sa dëshirojmë të shohim fytyrën e Perëndisë. Por në gjëndjen tonë të rënë askush nuk mund ta shohë Perëndinë dhe të jetojë. Kjo ishte ajo që i tha Perëndia Moisiut që ra me fytyrë përtokë para Perëndisë, dhe shumë të tjerëve si ai që ranë me fytyrë përtokë para një Perëndie të shenjtë. Serafinët në praninë e Perëndisë e mbylojnë fytyrën e tyre para Tij. Por po vjen një ditë kur do ta shohim atë ballë për ballë. Ecja jonë e besimit do të shndërrohet në një ecje të shikimit. Perëndia do të na e zbulojë veten në gjithë lavdinë e tij dhe për shkak se do kemi trupa të ringjallur do kemi mundësi të shohim fytyrën e tij dhe të jetojmë. A mund ta imagjinoni sesi do të jetë kjo gjë? A mund ta imagjinoni thellësinë e intimitetit, dashurisë dhe gëzimit në zemrat tona atë ditë?

Drejt kësaj po shkojmë – një marrëdhënie ballë për ballë me Të dhe këtë duhet të synojmë ta kapim. Kjo është arsyeja pse e lexojmë fjalën e Tij për shkak se dëshirojmë të dëgjojmë prej tij. Kjo është arsyeja pse lutemi për shkak se dëshirojmë të ecim me të. Njerëzit që kanë marrëdhënie komunikojnë me njëri-tjetrin. Kjo është arsyeja pse jemi mirënjohës. Kjo është arsyeja pse Pali tha tek Filipianëve 2:14, "Bëni çdo gjë pa u ankuar dhe pa kundërshtime." Ankesat dhe kundërshtimet i lëndojnë marrëdhëniet. Kjo është arsyeja pse ecim me të përmes vështirësive për shkak se përjetimi i përbashkët i vështirësive i bën

njerëzit më të lidhur njëri me tjetrin. **Përçafoni rritjen e kësaj marrëdhënieje për të cilën Krishti ju shpëtoi.**

Së treti, ai ju shpëtoi për një shërbesë e cila një ditë do të arrijë kulmin e vet në mbretërimin bashkë me të. Tani i kthehemi Zanafillës 1. Mendoj që ju kam treguar më parë sa shumë e përdor Zanafillën 1 për shkak se ajo është tepër themelore. Tek Zanafilla 1:26-28 shohim sesi Perëndia krijon njerëzimin simbas shembëlltyrës së tij gjë e cila ka idenë e rritjes në karakter për të cilën kemi folur si dhe idenë e shërbesës. Perëndia na krijoi të sundojmë mbi tokën. Në të ardhmen, ndërsa shohim shtegun para nesh mund të dallojmë që do mbretërojmë me Krishtin. Le të kthehemi tek Zbulesa 22. Pak më parë ju lexova katër vargjet e para. Ja se çfarë thotë vargu 5.

Dhe atje natë nuk do të ketë; edhe nuk kanë nevojë për llambë, as për dritë dielli, sepse Zoti Perëndi i ndriçon; dhe ata do të mbretërojnë në shekuj të shekujve.

Synimi i mbretërimit në parajsë do të rifitohet sërsish përmes Jezu Krishtit. Njerëzimi i shpenguar do të mbretërojë me Krishtin përjetë. Kjo është arsyeja pse Perëndia ju krijoi dhe pse Krishti ju shpëtoi. Si mund ta përqafojmë këtë gjë në jetën tonë?

Besoj që këtë e bëjmë në dy mënyra. Së pari, mësojmë sesi të shërbejmë. Ky është paradoksi i ndjekjes së Krishtit. Ne lartësohemi duke u përlurur. Shkojmë lart duke zbritur poshtë. Lartësohemi ndërsa e përlurim veten. Përgatitemi për të qenë mbretër duke mësuar si të jemi shërbëtorë. Tek 2 Korintasve 4:5 Pali thotë që predikonte dy gjëra: 1) Krishtin Jezus Zotin, dhe 2) veten si shërbëtor të tij. Ne e përgatisim veten për rolin tonë të ardhshëm të mbretërimit me Krishtin duke qenë sot një shërbëtor dhe arsyeja është që autoriteti dhe pushteti atë ditë do ushtrohen prej njerëzve të përlurur dhe të dashur dhe jo nga ata krenarë dhe egoistë që mendojnë se këto gjëra janë për avantazhin e tyre.

Një mënyrë e dytë sesi përgatitemi të mbretërojmë është duke mësuar mënyrën unike sesi na ka krijuar Perëndia dhe dhuntitë që na ka dhënë. Disa prej nesh kanë dhunti shërbimi dhe jemi shumë mirë në veprat e dashurisë. Disa kanë dhunti të foluri. Në këto dhunti mund të jemi të mirë për t'i folur njëri-tjetrit dhe për ta inkurajuar njëri-tjetrin. Ju mund të jeni shumë të mirë në grupet e vegjël. Mund të jeni tepër të mirë para turmave. Mund të jeni tepër të suksesshëm me jobsimtarët. Apo mund të jeni tepër mirë me kishën.

Dhuntitë tuaja të shërbimit mund të shkëlqejnë në kishë. Ato mund të shkëlqejnë në shërbim ndaj jobsimtarëve për t'i udhëhequr ata tek Krishti. Por cilado qoftë dhuntia juaj, zbulojeni, zhvillojeni dhe përdoreni për lavdinë e Krishtit. Kjo është arsyeja pse Krishti ju shpëtoi, që të jeni një shërbëtor për Të në kishë dhe në botë. **Përçafoni rritjen në shërbesë për të cilën Krishti ju shpëtoi.**

Përfundimisht, Krishti ju shpëtoi që të mund të përjetoni shpëtimin në aspektin frymëror por edhe në atë fizik. Fati juaj nuk është të jeni një frymë pa trup që qëndron pezull në qiell, apo diçka e tillë. Fati juaj është një fat fizik. Këtë gjë e kam përmendur tek libri im *Vizioni i Ringjalljes* ku ju tregoj dhjetë kuptimet e ringjalljes dhe njëri prej tyre është që ringjallja e Krishtit garanton ringjalljen tonë, që do të jetojmë përjetë në një trup të ri. Kjo është gjëja që e veçon Krishterimin nga fetë e tjera. Ato presin që të jenë diku në hapësirë. Ne presim për një ripërtëritje të tokës së Perëndisë dhe një ripërtëritje të trupit tonë.

Pali do të flasë për këtë gjë në fund të këtij kapitulli por tani për tani duhet të kuptojmë që ai na shpëtoi për të ripërtërirë jo vetëm shpirtin por edhe trupin tonë. Këtë realitet e përqafojmë duke ia paraqitur trupat tanë atij ashtu si Pali na thotë të bëjmë tek Romakëve 6:12 dhe 12:1. Mos e përdorni trupin për mëkat. Përdoreni për drejtësi. **Përqafoni fatin tuaj fizik duke ia ofruar forcën tuaj Perëndisë pasi kjo është arsyeja pse Krishti ju shpëtoi.**

Prandaj Pali thotë në këtë pjesë: “Jo se unë tashmë e fitova çmimin ose jam bërë i përsosur, por po vazhdoj të rend për ta zënë, sepse edhe unë u zura nga Jezu Krishti.”